



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

[Kryefaqja](#)[Kuvendi ▾](#)[Struktura ▾](#)[Dokumentacioni ▾](#)[Diplomacia parlamentare ▾](#)[Integrimi europian ▾](#)

Lajme

Postuar më 13/06/2024

U mblodh nënkomisioni “Për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësorë dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve”





Në drejtimin e kryetares znj.Klotilda Bushka u zhvillua mbledhja e radhës së nënkomisionit “Për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësorë dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve”.

Në rendin e ditës ishte seancat dëgjimore me kandidatët e kualifikuar për plotësimin e vakancave për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësorë dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve.

Kandidatët: znj. Eris Hysi, z. Erind Mërkuri, z. Erind Gërmenji, z. Albens Tabaku, z. Artan Reçi, z. Bledar Bajri dhe z. Saimir Kola paraqitën përpara nënkomisionit eksperiencën e tyre profesionale, vizionin dhe platformat e tyre kandiduese, si dhe iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve. Kandidati z. Klodian Gjermani nuk mori pjesë në dëgjësë, për arsye shëndetësore.

Pas dëgjësave, znj. Bushka hodhi në votim secili prej kandidatëve të kualifikuar. Deputeti z. Gazment Bardhi e vlerësoi procesin dhe vlerësimin e kandidatëve si të pambështetur në ligjin për organet e qeverisjes së organeve të drejtësisë dhe deklaroi se nuk do të merrnin pjesë në votim, ndërsa znj. Bushka argumentoi se procesi për përzgjedhjen ka qenë i rregullt dhe konform Kushtetutës .

Për shkak se asnjë prej kandidatëve nuk arriti të marrë numrin e votave të nevojshme, procedura vijoi me përzgjedhjen me short, nga ku u përzgjodhën z. Artan Reçi dhe z. Albenc Tabaku për KLGJ-në; si dhe z. Saimir Kola dhe z. Erind Mërkuri për KLP-në.

Në përfundim të mbledhjes znj. Bushka sqaroi se katër kandidaturat do ti kalojnë për shqyrtim seancës plenare

[Klikoni këtu për galerine](#)

Lajmet e fundit

FTESË PUBLIKE
DREJTUAR
ORGANEVE TË
MEDIAS
AUDIOVIZIVE,
MEDIAS SË

FTESË PUBLIKE
DREJTUAR
ORGANIZATAVE
TË SHOQËRISË
CIVILE,
INSTITUTEVE,

FTESË PUBLIKE
PËR
BASHKËPUNIM
DHE
EKSPERTIZË
NGA SHBA-JA,